



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE

**V E N D I M** (PROJEKT)  
(Nr. \_\_\_\_\_, datë \_\_\_\_\_ 2018)

**PËR**  
**“MIRATIMIN E KËRKESAVE PËR MENAXHIMIN E MBETJEVE METALIKE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe në zbatim të nenit 42, të ligjit nr. 10463, datë 22.9.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, Këshilli i Ministrave,

**VENDOSI:**

**I. TË PËRGJTHSHME**

1. Qëllimi i këtij vendimi është miratimi i kërkesave për menaxhimin e mbetjeve metalike, bazuar në praktikat më të mira, me qëllim:
  - a) Parandalimin, minimizimin e ndotjes së tokës nga rrjedhjet e lëngjeve dhe të ndotjes nga instalimet dhe pajisjet e pikës së grumbullimit dhe trajtimit të mbetjeve metalike;
  - b) Minimizimin e ndotjes nga ujërat e shiut, të shkarkuar nga instalimi i pikës së grumbullimit dhe trajtimit të mbetjeve metalike;
  - c) Minimizimi i ndotjes së ajrit duke përfshirë pluhurin, aromat, zhurmat dhe vibrimet gjatë proceseve të trajtimit të mbetjeve metalike;
  - d) Minimizimin e ndikimit në peisazh, duke kontribuar në këtë mënyrë në mbrojtjen, ruajtjen dhe përmirësimin e cilësisë së mjedisit.
2. Ky vendim ka për objekt përcaktimin e kërkesave dhe standarteve minimale mjedisore, teknikat, metodat, proceset dhe aktivitetet që lidhen me mbetjet metalike, të cilat çojnë në një minimizim të vazhdueshëm të efekteve negative në mjedis.

**II. FUSHA E ZBATIMIT DHE TERMAT E PËRDORUR**

1. Ky vendim është i detyrueshëm për zbatim për të gjithë operatorët që kanë venddepozitime për trajtimin apo riciklimin e skrapit të metaleve dhe që ushtrojnë aktivitetin e tyre në territorin e Republikës së Shqipërisë.

2. Termat e përdorur në këtë vendim kanë të njëjtin kuptim me termat e ligjit nr. 10463/2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, të ndryshuar, ndërsa termat e mëposhtëm kanë kuptimin, si më poshtë vijon:
  - a. “Mbetje të metaleve ferore” janë mbetjet metalike të hekurit dhe çelikut, të cilat përbëhen kryesisht nga metal hekuri dhe çeliku;
  - b. “Mbetje të metalit të aluminit” janë mbetjet metalike të aluminit dhe aliazheve të tij;
  - c. “Importues” është çdo person fizik ose juridik, i licencuar për menaxhimin e mbetjeve metalike sipas legjislacionit në fuqi, i cili importon mbetje metalike, që ka pushuar së qeni mbetje në vendin nga i cili importohet;
  - d. “Operator” është çdo person fizik ose juridik, që operon në grumbullimin, transportin, përpunimin dhe tregtimin e mbetjeve metalike, i licencuar sipas legjislacionit në fuqi për ushtrimin e aktivitetit;
  - e. “Rajon” ka kuptimin e një rajoni të administrimit të mbetjeve, që është përcaktuar në përputhje me planin kombëtar të menaxhimit të integruar të mbetjeve.

### **III. ROLI I AUTORITETEVE PUBLIKE**

1. Autoritetet publike, qendrore dhe vendore, në bazë të përgjegjësiave të tyre, miratojnë hapësira të përshtatshme për ushtrimin e veprimtarisë për grumbullimin, përpunimin dhe tregtimin e mbetjeve metalike, me kërkesë të operatorëve ekonomikë, si dhe monitorojnë zbatimin të këtij vendimi me anë të strukturave përkatëse.
2. Ministria, në bashkëpunim me autoritetet e tjera publike, qendrore dhe vendore, nxit dhe mbështet operatorët aktualë të marrin masat e nevojshme teknike, që veprimtarinë e tyre ta përshtasin me kërkesat e përcaktuara në këtë vendim.

### **IV. KËRKESAT PËR POZICIONIMIN E PIKAVE TË GRUMBULLIMIT DHE TRAJTIMIT TË MBETJEVE METALIKE**

1. Instalimet e grumbullimit dhe trajtimit të mbetjeve metalike që do t'i nënshtrohen procedurave të pajisjes me leje, licenca, autorizime apo miratime për ndërtimin e tyre, pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi, duhet të përmbushin kërkesat e mëposhtme, sa i takon vendit të ndërtimit të instalimit:
  - a) Të pozicionohen jo më pak se 1000 m larg nga të gjitha kategoritë e zonave të mbrojtura dhe zonat e rekreacionit bashkiake;
  - b) Të pozicionohen jo më pak se 1000 m larg nga zonat me rëndësi për biodiversitetin të miratuara nga autoritetet përkatëse;
  - c) Të pozicionohen jo më pak se 1000 m larg nga zonat ligatinore dhe sipërfaqet ujore (në veçanti liqenet dhe lumenjtë);
  - d) Të pozicionohen jo më pak se 500 m larg nga zonat ujëmbajtëse nëntokësore me shtresë të papërshkrueshme mbi të;
  - e) Të pozicionohen jo më pak se 500 m larg zonave të banuara;

- f) Të pozicionohen jo më pak se 300 m larg aktiviteteve industriale dhe tregtare në përputhje me Planin e Përgjithshëm Vendor të Bashkisë përkatëse;
- g) Të mos ndikojnë në dëmtimin e peisazhit natyror;

## **V. KËRKESAT MJEDISORE PËR PIKAT E DEPOZITIMIT DHE DEMONTIMIT**

1. Operatori ekonomik, i cili ushtron veprimtarinë në fushën e grumbullimit, trajtimit dhe riciklimit të mbetjeve metalike duhet:
  - a) Të ketë një sipërfaqe të papërshkrueshme nga uji, lëngjet, dhe substancat ndotëse, si dhe e qëndrueshme, e hidroizoluar dhe me infrastrukturën përkatëse të grumbullimit dhe drenazhimit të ujrave sipërfaqësore, rrjedhjeve të mundshme dhe ujrave të shiut;
  - b) Të ketë impiant për trajtimin e ujrave, duke përfshirë edhe ujrë të shiut, dhe sipas rastit, dekantues me qëllim trajtimin dhe eliminimin e përbërësve të rrezikshëm;
  - c) Të ketë hapësira të përshtatshme për ndarjen dhe depozitimin e diferencuar të materialeve të ardhura në pikën e grumbullimit të mbetjeve metalike.
2. Impiantet e trajtimit të mbetjeve metalike duhet të jenë të rrethuara, me qëllim shmangien e hyrjeve të personave të paautorizuar, si dhe për të parandaluar rrjedhat e ujrave sipërfaqësore brenda territorit të impiantit.
3. Rrethimet duhet të jenë të ndërtuara me mure dhe dysHEMEJA e instalimit duhet të ndërtohen nga materiale të papërshkrueshme.

## **VI. MATERIALET QË DUHET TË PRANOHEN NË NJË PIKË GRUMBULLIMI TË MBETJEVE METALIKE**

1. Materialet e riciklueshme të mbetjeve metalike, që vijnë nga çdo zotërues, grumbullues, individ ose çdo person apo palë e tretë me mjete të ndryshme transporti, duhet të:
  - a) peshohen,
  - b) kontrollohen dhe
  - c) pranojnë nga operatori përpara se ato të ndahen dhe përpunohen.
2. Operatori i mbetjeve metalike, nuk duhet të pranojë në instalim, materialet e listuara më poshtë:
  - a) Enë nën presion (p.sh. ato të LPG apo GLN, oksigjenit, acetilenit, etj.);
  - b) Jo metalike (goma, shkuma, sfungjera, etj.);
  - c) Substanca kimike (p.sh. klori i pishinës, bojrat, asbestin, etj.);
  - d) Substanca të rrezikshme (p.sh., shiringa, gjilpëra dhe të mprehta, etj.);
  - e) Substanca të ndezshme dhe shpërthyes (p.sh., zbardhues, pastrues dhe dezinfektues, etj.);
  - f) Konteinerët e mbyllur ose të salduar, që nuk kanë përbërje metalike;
  - g) Bateri, që nuk janë neutralizuar dhe çertifikuar si të pastër me kapak të hequr;

- h) Materiale radioaktive;
  - i) PCB (Bifenil i poliklorinuar);
  - j) Pajisje që përmbajnë substancat ozonholluese (p.sh. frigoriferët e vjetër, etj);
  - k) Mbetje spitalore.
3. Operatori, në procedurat e pranimit të ngarkesave të mbetjeve metalike në instalim, duhet të:
- a) kryejë kontrollin fillestar të ngarkesës me kontroll vizual dhe kur është e mundur me aplikimin e pajisjeve dhe teknologjive bashkëkohore, me qëllim parandalimin e pranimit të mbetjeve të tjera, të palejuara në këtë instalim të grumbullimit dhe depozitimit të mbetjeve metalike, sipas përcaktimit të pikës 2 më sipër;
  - b) Konstatimi i pranisë së materialeve të papranueshme, të listuara në pikën 2 më sipër, në ngarkesën e mbetjeve, konsiderohet shkelje ligjore dhe bie në kundërshtim me kërkesat e përcaktuara në këtë vendim për operimin e instalimeve të grumbullimit dhe përpunimit të mbetjeve metalike;
  - c) Në rast konstatimi të shkeljes ligjore, të cituar më sipër, operatori është objekt i sanksioneve të përcaktuara në ligjin nr.10463, datë 22.09.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, të ndryshuar.

## **VII. KËRKESA TEKNIKE TË PIKAVE TË GRUMBULLIMIT DHE TRAJTIMIT TË MBETJEVE METALIKE**

1. Organizimi i brendshëm i operacioneve apo aktiviteteve në një instalim të grumbullimit dhe trajtimit të mbetjeve metalike, duhet të jetë si më poshtë:
  - a) Të vendosen pranë njëra-tjetrës procese pune të ngjashme ose të lidhura me njëra-tjetrën, me qëllim që të minimizohet përhapja e ndotjes përgjatë gjithë sheshit të grumbullimit dhe trajtimit të mbetjeve metalike;
  - b) Pikat e grumbullimit, ruajtjes dhe trajtimit të mbetjeve metalike duhet të jenë të pajisura me një sistem të mbrojtjes nga zjarri, të miratuar nga autoritetet përkatëse;
  - c) Në procesin e përpunimit të mbetjeve metalike (copëtimi dhe presimi), duhet të merret në konsideratë minimizimi i çlirimit të zhurmave, vibrimeve dhe shkarkimeve në ajër, duke aplikuar kapanone të mbyllura, kur është e mundur dhe të pajisur me sistem ventilimi dhe filtrimi.
2. Instalimi duhet të ketë të miratuar nga autoritetet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, një plan masash për emergjencat, lidhur me parandalimin e shkarkimeve të ujrave të ndotura dhe /apo kimikateve në mjedis.
3. Instalimi duhet të ketë pajisjet e nevojshme për minimizimin e ndotjes dhe kontrollin e shkarkimeve që të jenë brenda normave të përcaktuara në legjislacionin në fuqi.
4. Mbetjet që gjenerohen gjatë procesit teknologjik të instalimeve për grumbullimin dhe përpunimin e mbetjeve metalike menaxhohen në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi për menaxhimin e integruar të mbetjeve.

## **VIII. PARANDALIMI I NDOTJES**

1. Më qëllim parandalimin e ndotjes në mjedisin ku ushtrohet aktiviteti, çdo operator detyrohet:
  - a. Të kontrollojë ose përshtasë proceset e punës për të parandaluar dhe minimizuar shkarkimin e ndotësve në mjedis;
  - b. Të trajtojë ujrat dhe mbetjet e lëngta, të cilat shkarkohen nga instalimet e trajtimit të mbetjeve metalike, përpara shkarkimit të tyre në mjediset ujore pritëse dhe/apo në sistemin e kanalizimeve.
  - c. Të ndërmerren masat e nevojshme për sigurimin e punonjësve me veshje dhe pajisje që të parandalojnë rreziqet e dëmtimit të shëndetit të tyre nga substancat e rrezikshme.

## **IX. REGJISTRAT DHE INFORMIMI**

1. Operatori gjatë blerjes, marrjes, apo pranimit të mbetjeve metalike, në të njëjtën kohë duhet të regjistrojë në regjistrat përkatës:
  - a. Përshkrimin e mbetjes metalike, duke përfshirë llojin e metalit apo aliazhit, të dhënat e personit që merr në dorëzim dhe personit që dorëzon mbetjet (emri mbiemri, adresa, nr. identifikimit/ID), sasinë e mbetjeve, llojin e ambalazhimit (në thasë, kontenierë, kosh metalik), numri unik i identifikimit të subjektit (NUIS), tipi i lejes së mjedisit A, B, C dhe licensës III.2.B të dorëzuesit dhe marrësit të mbetjeve;
  - b. Datën dhe orën e marrjes dhe lëshimit të faturës/dokumentit;
  - c. Nëse mbetjet metalike dorëzohen nga një automjet, duhet të rregjistrohet dhe të pasqyrohet edhe targa e automjetit, numri i lejes së qarkullimit dhe emri i drejtuesit të mjetit;
  - d. Në lëshimin e kuponit të pagesës/faturës, të shënohet edhe emri i personit që pranon materialin ose që vepron në emër të operatorit, i autorizuar prej tij.

## **X. KËRKESAT PËR PRANIMIN, GRUMBULLIMIN, SELEKSIONIMIN DHE DEPOZITIMIN E MBETJEVE METALIKE**

1. Pas pranimit të mbetjeve metalike, operatori duhet:
  - a. Të sistemojë mbetjet metalike në zonën e përcaktuar për seleksionim paraprak, brenda sheshit të impiantit, përpara se të transferohen në venddepozitimin respektiv për përpunim të mëtejshëm.
  - b. Zonat e seleksionimit të vendosen në afërsi të zonave të përcaktuara për depozitimin e produkteve, për të minimizuar lëvizjen e tepërt të pajisjeve/automjeteve në sheshin e depozitimit në instalim.
2. Mbetjet metalike, gjatë depozitimit, ruajtjes dhe përpunimit, vendosen në stoqe, në distanca të përshtatshme midis tyre, duke siguruar gjithmonë rrugëkalimi të lirë ndërmjet tyre, vendosen në struktura të qëndrueshme, të papërshkrueshme nga uji dhe

materialet e lëngshme, siç janë strukturat e betonit. Struktura e betonit ndihmon në pengimin e rrjedhjes së lëngjeve.

3. Kanalet kullues dhe drenazhues të sheshit të depozitimit duhet të përfundojnë në një sistem mbledhës dekantues dhe nuk duhet të përzihen me ujrat e shiut.

## **XI. SISTEMET E KOLEKTORËVE TË UJËRAVE TË NDOTUR**

1. Sheshi i depozitimit dhe trajtimit të mbetjeve metalike dhe i gjithë instalimi duhet të jetë i pajisur me sistem drenazhimi/kullimi, për të mbledhur ujrat sipërfaqësore.
2. Pikat hyrëse të ujrave të shiut, duhet të jenë qartësisht të evidentuara, në mënyrë që të identifikohen lehtësisht dhe të merren masa për grumbullimin e tyre brenda instalimit;
3. Operatori është përgjegjës për zbatimin e kërkesave të këtij vendimi, si dhe kushtet e lejes së mjedisit dhe licencës III.2.B që disponon, me qëllim mbrojtjen e mjedisit dhe minimizimin e shkarkimeve të ujërave të ndotura industriale, të pa trajtuara, në mjediset ujore.
4. Operatori është përgjegjës për zbatimin e këtyre kërkesave, si dhe detyrimet, kushtet e kufizimet që kanë leja e mjedisit dhe licenca që disponon, ku përcaktohen mënyrat për ruajtjen dhe depozitimin e ujrave të ndotura dhe mbetjeve të lëngshme, duke përfshirë, ruajtjen e mbetjeve të rrezikshme për të siguruar që praktikatat që aplikohen, janë në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e mjedisit.

## **XII. KËRKESAT PËR KONTROLLIN E KIMIKATEVE DHE SHKARKIMEVE TË LËNGSHME**

1. Shkarkimet e lëngshme dhe kimikatat duhet të trajtohen, ruhen dhe depozitohen në mënyrë të përshtatshme dhe më konkretisht:
  - a) Karburantet dhe mbetjet e tjera në formë të lëngshme, përveç ujrave të ndotura teknologjike, duhet të mblidhen përpara çdo procesi përpunimi ose depozitimi të mbetjeve metalike që vijnë nga automjetet, makineritë dhe pajisjet që operojnë në instalim.
  - b) Lëngjet që grumbullohen duhet të depozitohen në një zonë të mbuluar dhe të rrethuar dhe me strukturë të qëndrueshme dhe të papërshkrueshme.
  - c) Praktikatat e trajtimit të lëngjeve dhe kimikateve duhet të jenë të përshtatshme për të mbajtur dhe depozituar në mënyrë të sigurtë të gjitha lëngjet e gjeneruara në instalim. Kjo duhet të përfshijë edhe një sistem me pajisjet e nevojshme për kontrollin dhe eliminimin e derdhjeve/rrjedhjeve. Ky sistem duhet të jetë gjithmonë në gjendje pune në instalim.
  - d) Instalimet duhet të kenë një procedurë të dokumentuar, ku të jetë e përshkruar se si do të parandalohen rrjedhjet/derdhjet dhe se si do të veprohet nëse ndodh një derdhje/rrjedhje. Kjo procedurë duhet të rishikohet në rast se kemi ndryshim apo shtim teknologjie në instalim dhe duhet përshtatur me ndryshimet në instalim.
  - e) Të gjitha mbetjet e lëngshme, të grumbulluara, duhet të dërgohen në një impiant/operator të licencuar për trajtimin e mbetjeve të lëngshme dhe duhet të

mbahen të dhëna apo regjistër për dorëzimin e tyre në impiantin/operatorin e kontraktuar.

### **XIII. MBETJET NGA PAJISJET ELEKTRIKE DHE ELEKTRONIKE**

1. Elektroshtëpiaket, pajisjet elektronike edhe mbetjet e tjera elektrike dhe elektronike, që përmbajnë mbetje metalike, duhet të pastrohen nga mbetjet e tjera.
2. Pas copimit në copëtues, elektroshtëpiaket dhe mbetjet e tjera elektrike që dërgohen në mullirin me çekiç dhe/ose në copëtues ose për përpunime të tjera, qoftë në instalim ose jashtë tij, duhet të pastrohen nga mbetjet e tjera që nuk janë mbetje metalike, përfshi dhe ato mbetje që nuk janë pjesë e pajisjes origjinale.
3. Substancat ozonholluese në pajisjet frigoriferike dhe kondicionerët duhet të rikupërohen dhe depozitohen në përputhje me legjislacionin në fuqi për substancat ozonholluese dhe detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni për substancat që hollojnë shtresën e ozonit.
4. Kondensatorët në llambat fluoreshente, të cilat mund të përmbajnë PCB, të vendosen në ambalazh polietileni, i cili depozitohet në një kontenier metalik të mbyllur.
5. Pas grumbullimit, kondensatorët duhet të transportohen nga një transportues i licensuar, për t'u depozituar në një impiant/venddepozitim të licensuar për të grumbulluar dhe trajtuar këto mbetje. Dorëzimi duhet të bëhet me dokument midis palëve ku të evidentohet sasia.

### **XIV. KONTROLLI I ZHURMAVE DHE DRIDHJEVE**

1. Transportimi, vetëshkarkimi, lëvizje dhe manovrimi, përpunimi dhe seleksionimi i mbetjeve metalike në instalimet e grumbullimit dhe trajtimit, duhet të bëhet në mënyrë të kontrolluar dhe profesionale, duke minimizuar kështu zhurmat dhe dridhjet:
  - a) Makineritë dhe pajisjet duhet të mirëmbahen dhe shfrytëzohen në kushte të përshtatshme dhe efçente, duke minimizuar kështu zhurmat dhe dridhjet.
  - b) Instalimet e grumbullimit dhe përpunimit të mbetjeve metalike, duhet të kenë një procedurë të dokumentuar, ku të përshkruhet si do të shmangen ose minimizohen zhurmat dhe dridhjet. Kjo procedurë duhet të rishikohet në rastet kur ndryshon mënyra e operimit të instalimit, si dhe kur futen në shfrytëzim makineri dhe pajisje të reja.

### **XV. INSPEKTIMI**

1. Inspektorati shtetëror përgjegjës për mjedisin inspekton të gjithë operatorët ekonomikë, që zotërojnë instalime të grumbullimit, transportit dhe përpunimit të mbetjeve metalike, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e mjedisit, menaxhimin e integruar të mbetjeve, lejet e mjedisit dhe për inspektimin në Republikën e Shqipërisë.
2. Operatorët ekonomikë, të cilët janë subjekt i këtij vendimi, u vënë në dispozicion inspektoriatit shtetëror përgjegjës për mjedisin, pas kërkesës së tyre me shkrim, të

gjithë dokumentacionin dhe të dhënat e nevojshme për kryerjen e inspektimeve në instalim.

#### **XVI. DISPOZITA KALIMTARE DHE TË PËRGJITHSHME**

1. Të gjithë operatorët ekonomikë, që zotërojnë një instalim ekzistues për grumbullimin, depozitimin dhe përpunimin e mbetjeve metalike, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, duhet të marrin të gjitha masat teknike, ligjore, rregullatore për të qenë në përputhje me kërkesat e këtij vendimi.
2. Të gjithë operatorët ekonomikë, që zotërojnë një instalim ekzistues për grumbullimin, depozitimin dhe përpunimin e mbetjeve metalike brenda 6 muajve pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi duhet të aplikojnë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB), për rishikimin e kushteve të lejes së mjedisit, sipas procedurave të përcaktuara në legjislacionin në fuqi për lejet e mjedisit.
3. Pas kalimit të afatit të përcaktuar në pikën 1 të këtij kreu dhe në çdo rast kur nga strukturat e kontrollit, monitorimit dhe inspektimit, konstatohet mospërmbyshja e këtyre kërkesave të këtij vendimi, ndërmerren masat ligjore dhe administrative për ndërprerjen, pezullimin, mbylljen apo sekuestrimin e instalimit, sipas shkallës së shkeljes.
4. Ngarkohen Ministria e përgjegjëse për mjedisin, Agjencia Kombëtare e Mjedisit, njësitë e qeverisjes vendore dhe inspektoriati shtetëror përgjegjës për mjedisin për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**

**EDI RAMA**